

VENDIM
Nr. 60, datë 29.1.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIVITALIZIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I TREGUT
FRUTA-PERIME NË LAGJEN ‘KONGRESI I ELBASANIT’, NË ZONËN
KADASTRALE 8521”, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rivitalizimi dhe rikonstruksioni i Tregut Fruta-Perime në lagjen ‘Kongresi i Elbasanit’, në zonën kadastrale 8521”, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme, prej 1 410 660.46 (një milion e katërqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë dyzet e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 410 660.46 (një milion e katërqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë dyzet e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “RIVITALIZIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I TREGUT FRUTA-PERIME, NË LAGJEN ‘KONGRESI I ELBASANIT’, NË ZONËN KADASTRALE 8521”, BASHKIA ELBASAN

N R.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM						SHENI ME (D+E) (Kufizim i hipotekës e, bazuar në mbasi pasuritit etj.)	
	EMRI	ATËSI A	MBIEMI RI	Fshati ose Qyteti	Zona Kadastrale	No. pasurisë	Lloji i pasuritë	Sipërfaqja Totale	"Tmali I" (m2)	"Ndërtesa e" (m2)	Volumi	Faqe	"TRUALL"			"NDËRTESE"				
													Sipërfaqja (m2)	Çmimi (ëkë/m2)	Vlera (ëkë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (ëkë/m2)	Vlera (ëkë)		
1	ARMAN DO	ZAGO LL	BRINJA		8521	5/99	NDËRTESE	42	0	42	21	72				42		1,410,666. 46	1,410,666. 46	Shënimet të pronarëve i pasurisë nr. 5/00 VOR. 14 Faq. 243 nëse të cilës ndodhet ndërtesa me nr. 5/99
	DISUEL	ZAGO LL	BRINJA																	
VLERE TOTALE																			1,410,666. 46	

Vlerësimi për pasurinë e llojit “ndërtesë” është bërë me preventiv punimesh, bazuar në pikën 3, të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurisë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.